

Intro: i ftuari i mëngjesit tek SRF 1.

MODERATORI: Në më shumë se 40 vende, ekspertë zviceranë po punojnë për bashkëpunim dhe zhvillim. 160 prej tyre po takohen këto ditë në Zvicër për një shkëmbim dhe seminar. Z. Christoph Graf është një prej tyre. Ai ka qenë në Shqipëri për dy vjet e gjysëm dhe në të njëjtën kohë është kreu i bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillim midis Shqipërisë dhe Zvicrës. Mirëmëngjes, Christoph Graf.

CHRISTOPH GRAF: Mirëmëngjes Z. Brunner.

MODERATORI: Z. Graf, më tregoni, Shqipëria është një vend që po ecën tashmë, a ka diçka për të bërë për ju?

CHRISTOPH GRAF: Po, në të vërtetë Shqipëria është një vend Evropian por është një nga vendet më të varfra të Evropës. Sidoqoftë, mund të themi se në të njëjtën kohë ka kaluar përmes ndryshimeve të mëdha në 25 vitet e fundit. Sepse 25 vjet më parë, Shqipëria ishte në fakt në nivelin e Koresë së Veriut, me një diktaturë shumë të izoluar dhe drastike.

MODERATORI: Si është dita juaj e përditshme në atë vend?

CHRISTOPH GRAF: Po ja, unë kam një funksion shumë interesant, takoj shumë njerëz, më duhet të negocioj me shumë njerëz nga zona të ndryshme, natyrisht dhe me përfaqësues të qeverisë, por edhe me sipërmarrës privatë të cilët vijnë apo të cilët unë i vizitoj, ose me njerëz nga sektori kulturor por edhe me përfaqësues nga OJQ-të. Në këtë aspekt, ka një rang shumë të gjerë.

MODERATORI: Ku ndjeheni më rehat, me këpucë lëkure firmato në skenën diplomatike, apo me çizme plastike duke ndihmuar diku?

CHRISTOPH GRAF: Në fakt unë kam një funksion të dyfishtë, nga njëra anë jam kreu i programmit të zhvillimit përmes të cilit Zvicra investon rreth 20 milion Franga zvicerane në vit në Shqipëri dhe mbështet Shqipërinë. Nga ana tjetër jam gjithashtu ambasador i Zvicrës dhe përfaqësoj Zvicrën "zyrtare" në atë vend dhe natyrisht jam i interesuar për marrëdhënie të mira. Dhe marrëdhëniet janë në të vërtetë të mira dhe ndodh që edhe Kampionati Evropian i futbollit bëhet një ndërmjetësues shumë i mirë dhe shprehës i marrëdhënieve të mira. Patëm përvojë interesante dhe të këndshme gjatë Kampionatit Evropian të futbollit.

MODERATORI: Pra, meqenëse iu adresuat kësaj, vëllezërit Xhaka luajtën kundër njëri-tjetrit dhe ju e patë ndeshjen bashkë me Presidentin e Shqipërisë. A do të ishin këto kontakte personale të mundura po të mos ishte ndeshja e futbollit?

CHRISTOPH GRAF: Kontaktet personale janë shumë të rëndësishme por emocionet në një ndeshje futbollit natyrisht që ndihmojnë për të njohur ata persona, ministra dhe në këtë rast vetë Presidentin, më mirë dhe për të vlerësuar njëri-tjetrin më shumë. Shqipëria dhe Zvicra kanë shumë ngjashmëri në këtë sens, ne jemi relativisht vende të vogla dhe është interesante që Shqipëria është gjithashtu një vend malor pavarësisht se ndodhet në Detin Adriatik.

MODERATORI: Më thuaj, si i përjeton shqiptarët në jetën e përditshme, mentalitetin?

CHRISTOPH GRAF: Shqiptarët nuk kanë një reputacion krejtësisht të mirë në Zvicër dhe këtë ma thanë kur nisa punën. Dhe më pas kur pashë realitetin në terren, më duhet të them se gjeta diçka krejt ndryshe. Ata janë njerëz shumë të hapur, shumë të përzemërt, emocionalë gjithashtu, dhe duan të ecin përpara, dhe në fakt kanë ecur përpara. Ata janë të zellshëm dhe duan të punojnë. Në këtë sens, këtë aspekt e sheh më pak kur flitet për anët negative të shqiptarëve këtu në Zvicër. Ndoshta duhet thënë edhe se shqiptarët në Zvicër nuk janë persona vetëm apo kryesisht nga Shqipëria por janë zakonisht nga Kosova dhe Maqedonia. Kështu komuniteti i shqiptarëve përbëhet nga një grup etnik që jeton në tri vendet, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

MODERATORI: Por a keni përvoja që kanë mbetur tek ju, të cilat nuk do të ndodhnin po të ishit këtu në Zvicër?

CHRISTOPH GRAF: Ne jetojmë në qendër të Tiranës dhe më pëlqen të jem në qytet, është një qytet me jetë, dhe ka shumë shitës frutash dhe perimesh në trotuare të cilët shesin produkte pothuaj direct nga fshati. Dhe kur blej portokalle zakonisht me japin gjithashtu disa mollë apo mandarina të cilat i ofrojnë si dhuratë për të patur marrëdhënie të mira me klientët. Në se thua se je nga Zvicra ke një bonus. Pra, sheh një butësi dhe gëzim që shprehet dhe që ndoshta nuk e gjen në këtë formë në Zvicër.

MODERATORI: Z. Graf, ju falënderoj shumë për këtë pamje të jetës në Shqipëri. Çfarë po ju mungon këto ditë?

CHRISTOPH GRAF: Më mungon ushqimi i mirë që kemi në Shqipëri. Është zakonisht i lehtë, mesdhetar, shpesh me shumë ushqime deti dhe peshk.

MODERATORI: Mirë por pak Cervelat (salçiçe zvicerane) nuk është keq herë pas here, apo jo?

CHRISTOPH GRAF: Kjo është mirë gjithashtu, po. Edhe unë e shijoj. Dhe Raclette (djath i shkrirë) gjithashtu ishte e pranishme me ne në 1 Gusht në Ambasadën zvicerane në Tiranë.

MODERATORI: Falemnderit Z. Graf, ju uroj një shkëmbim të këndshëm me kolegët tuaj dhe një ditë të mirë.

CHRISTOPH GRAF: Falemnderit, edhe ju gjithashtu.